

1 E enjte, 2 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë
13 W0208. Vërej, për procesverbal, që pas marrjes së lejes
14 dëshmitari po jep dëshmi përmes videolidhjes. Po ashtu, siç e
15 tha Trupi Gjykses, ky dëshmitar, pra, Dëshmitari 00208 do të
16 japë dëshmi përmes videokonferencës siç është parashtruar në
17 parashtrimin e protokolluar F0146.

18 Siç kemi bërë dhe në seanca të tjera, do i kërkoja
19 Sekretares të na kalojë në seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 jemi në seancë publike.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
9 Sekretarja e seancës, që është ulur pranë teje, do t'ju japë
10 një tekst të betimit solemn që duhet ta lexoni në përputhje me
11 rregullin 141, paragrafi 2 i Rregullores. Shkronjat janë të
12 vogla. A mund ta lexoni vetë? Në qoftë se nuk e lexoni dot
13 mund t'ua lexoj unë dhe mund ta përsërisni pas meje.

14 Ju lutem lexojeni me zë.

15 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Mund ta
16 lexoj. Duhet ta lexoj tani?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, duhet ta
18 lexoni tani.

19 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I
20 ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë
21 time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën,
22 krejt të vërtetën dhe asgjë tjetër përveç të vërtetës dhe nuk
23 do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

24 DËSHMITARI: W00208

25 [Dëshmitar përgjigjet përmes përkthimit]

1 [Dëshmitari paraqitet përmes videolidhjes]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
3 Dëshmitar. A mund ta përsërisni dhe një herë, Dëshmitar, se
4 nuk ju dëgjuam? Ka probleme lidhja.

5 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Duhet ta
6 lexoj dhe një herë tjetër?

7 I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime -- edhe
8 një herë.

9 I ndërgjegjshëm dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
10 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
11 asgjë tjetër përveç të vërtetës dhe nuk do të mbaj të fshehtë
12 asgjë për të cilën kam dijeni.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'ia
14 ktheni përsëri dokumentin Sekretarit të Gjykatës.

15 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
16 Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A e dëgjoni
18 mirë përkthimin?

19 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Deri tani e
20 dëgjoj shumë mirë përkthyesit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që pritet që të
23 zgjasë mesatarisht një ditë.

24 Sikurse mund ta dini, Prokuroria do t'ju bëj së pari
25 pyetje. Pasi të përfundojë Prokuroria, Mbrojtësit e të

1 akuzuarve mund të kenë pyetje për ju, ashtu siç edhe anëtarët
2 e Trupit Gjykues.

3 Prokuroria ka vlerësuar që do i duhet rreth gjysmë ore
4 për t'ju bërë pyetje. Ndërkohë, që Mbrojtjet kanë vlerësuar se
5 ju duhen katër orë. Si me çdo vlerësim tjetër të kohës,
6 shpresojmë që Mbrojtjet mund ta përdorin kohën në dispozicion
7 të tyre sa me mënyrë efikase të jetë e mundur. Trupi Gjykues
8 mund të lejojë gjithashtu edhe pyetje plotësuese.

9 Ju lutem mundohuni që t'i jepni përgjigje pyetjeve me
10 fjali të shkurtra dhe të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni
11 pyetjen, mund t'i thoni avokatit që nuk e kuptoni pyetjen ose
12 kërkojini atyre që t'ua thjeshtësojnë ose ta formulojnë atë
13 ndryshe.

14 Po ashtu thoni se cila është baza e njohurive, fakteve
15 dhe rrethanave për të cilat do të pyeteni. Në rast se ZPS-ja
16 ju kërkon që të vërtetoni disa korrigjime të bëra në
17 deklaratat tuaja të mëparshme, juve ju kujtohet që të
18 konfirmoni për procesverbal që korrigjimet e dhëna në listën e
19 Prokurorisë, pasqyrojnë me saktësi komentet tuaja.

20 Ju lutem mos harroni që të flisni përpara mikrofonit,
21 prisni pesë sekonda përpara sesa të jepni përgjigje pyetjes
22 edhe flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju kapin
23 plotësisht përkthyesit.

24 Këtë ditë ku do të jepni dëshmi në Gjykatë, nuk lejoheni
25 që të diskutoni me askënd lidhur me përmbajtjen e dëshmisë

1 suaj, jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se një person, ndonjë
2 person vjen për t'ju bërë pyetje lidhur me këtë dëshmi, ju
3 lutem na e bëni të qartë këtë gjë.

4 Trupi Gjykses e kupton që ZPS-ja ka kopje fizike të
5 deklaratave të mëparshme të dëshmitarit që e keni dhënë ju, në
6 mënyrë që ju, në qoftë se është e nevojshme mund t'i
7 konsultoni, mund t'i shikoni këto dokumente. Në qoftë se do
8 jetë nevoja prej jush që t'i shikoni këto dokumente, ju lutem
9 tregojani Trupi Gjykses këtë gjë.

10 Po ashtu, ju lutem mos flisni më, në qoftë se ju kërkohet
11 që të mos flisni apo në qoftë se e ngre dorën për t'ju treguar
12 që nuk duhet të flisni më, se kjo do të thotë që kam disa
13 udhëzime për t'ju dhënë. Në qoftë se e keni të nevojshme të
14 bëni pushime na e thoni këtë gjë dhe ne do të bëjmë
15 organizimet e nevojshme.

16 Z. Prokuror, fjala për ju.

17 Pyetje nga z. Michalczuk:

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

19 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Më dëgjoni mirë?

20 PË. Mirëmëngjes, ju dëgjoj shumë mirë.

21 PY. Unë quhem Cezary Michalczuk dhe jam Prokuror. Do t'ju bëj
22 disa pyetje sot për 30 minutat në vijim.

23 Ju lutem, a mund të thoni si quheni, emrin dhe mbiemrin
24 për procesverbal?

25 PË. Unë quhem Pedrag Dedic.

1 PY. Kur keni lindur?

2 PË. Kam lindur më 21 mars 1932.

3 PY. Dëshmitar, në të shkuarën keni dhënë shumë deklarata për
4 autoritet të ndryshme. Tani do të kërkoj që të paraqiten në
5 ekran deklaratat e mëhershme që keni dhënë. Nëse nuk i shikoni
6 siç duhet në ekran, ju lutem shikoni dosjen që keni përpara
7 dhe sikurse ju kërkoj Kryegjykatësi, ju lutem tregojini Trupit
8 Gjykses sa herë që ju shihni dosjen që keni përpara dhe
9 dokumentet përkatëse në të.

10 PË. Në rregull.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të
12 paraqisni në ekran dokumentet që do të citoj për pak në
13 versionin në anglisht dhe në serbisht. Versioni në anglisht
14 është 007623 deri në 007632 RED2. Dhe këtu, deklarata fillon
15 nga faqja 007627. Faleminderit. Dhe versionin në gjuhën serbe
16 është U002-9743-U002-9746 RED2.

17 PY. Dëshmitar, a i keni përpara deklaratat?

18 PË. Po. Po, i shikoj në ekran deklaratat. E shikoj shënimin e
19 intervistës së dëshmitarit.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Kam vështirësi teknike që të shikoj
21 dokumentet në ekran. Domethënë, me fjalë të tjera po shtyp
22 këtë butonin e provave dhe nuk shikoj asnjë dokument që të më
23 shfaqet në ekran.

24 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
25 këshillohen]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
2 kemi pak vonesë, se kemi një vështirësi teknike këtu.

3 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në rregull.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në
5 rregull që të vazhdojmë më tej.

6 Mund të vazhdoni, z. Prokuror.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje lidhur me
9 këto deklarata. Kjo deklarata që keni përpara ka të bëjë me
10 një dëshmi dëshmitari -- edhe një herë.

11 Dëshmitar, kjo i referohet një seance me një dëshmitar,
12 të realizuar më 31 maj të vitit 2000, përpara Gjykatësit
13 hetues në Gjykatën e Beogradit. A e keni dhënë ju këtë dëshmi,
14 Dëshmitar?

15 PË. Po, e kam dhënë këtë dëshmi në Beograd.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të
17 kaloni tek faqja 4 në versionin serbisht të kësaj deklarate,
18 për procesverbal është dokumenti U002-9746.

19 PY. Dëshmitar, a e shihni këtë faqen në versionin në serbisht
20 edhe një nënshkrim në fund të faqes? E shikoni këtë në ekran?

21 PË. Po, e shoh.

22 PY. A është nënshkrimi juaj ky?

23 PË. Po, është nënshkrimi im.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare e seancës, a
25 mund të paraqisni në ekran dy dokumente të tjera tani që janë

1 dy deklarata të tjera. Për procesverbal, versioni në anglisht
2 është dokumenti U000-0009 deri në U000-0016 RED2. Versioni në
3 serbisht ka të njëjtin numër identifikimi po përfundon me -SR
4 RED në fund.

5 PY. Dëshmitar, a shihni një deklaratë tjetër në ekranin që
6 keni përpara, një dokument tjetër tani?

7 PË. Po, po. E shoh, e shoh mirë.

8 PY. Ky është dokument i cili ka të bëjë me intervistën që
9 keni dhënë më datë 10 gusht 2001, pra, kjo është deklarata që
10 keni dhënë përpara TPNJ-së, Tribunalit për ish-Jugosllavinë.

11 Pyetja që kam për juve është kjo: A e mbani mend që ta keni
12 dhënë këtë deklaratë përpara TPNJ-së?

13 PË. Po, po, me siguri.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] A mund të kalojmë në faqen 7 të
15 këtij dokumenti në versionin në anglisht, për procesverbal,
16 është faqja U000-0015.

17 PY. Dëshmitar, a e shihni nënshkrimin në dokumentin që keni
18 përpara në ekran?

19 PË. Po, e shoh.

20 PY. A është nënshkrimi juaj ky?

21 PË. Ku e shikoni nënshkrimin tim? E shikoj datën 10 gusht, po
22 nuk shikoj nënshkrimin dot.

23 PY. E kam fjalën për versionin në anglisht. Duhet ta keni në
24 të djathtë të ekranit?

25 PË. Po, në anglisht e shikoj. E shikoj nënshkrimin tim në

Dëshmitari: W00208 (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Michalczuk

Faqe 11

1 versionin në anglisht.

2 PY. A është nënshkrimi juaj ky?

3 PË. Po, është. Është nënshkrimi im.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund të
5 kalojmë në një tjetër dokument tani? Versioni në anglisht
6 është, pra, materiali 007631-TR-ET Pjesa 1 RED2 dhe dokumenti
7 në serbisht ka të njëjtin numër identifikimi por nuk ka këtë
8 pjesëzën ET, shtojcën ET në fund, Pjesa 1, po ashtu në të dyja
9 versionet.

10 PY. Dëshmitar, a shikoni një grup tjetër dokumentesh përpara
11 jush?

12 PË. Po.

13 PY. Kjo është intervista më datë 12 dhjetor 2013, që është
14 marrë nga Njësia e Posaçme Hetimore. A ja keni dhënë këtë
15 deklaratë këtij institucioni, Dëshmitar?

16 PË. Po, e kam dhënë.

17 PY. Dëshmitar, gjatë seancës për përgatitjen e dëshmitarit të
18 organizuar rishtazi, pra, që u realizua më datë 13 shtator
19 2023, që ka ndodhur në shtëpinë tuaj dhe unë vetë kam qenë i
20 pranishëm aty, gjatë këtij takimi a ju është mundësia që të
21 rishikoni të gjitha deklaratat e mëhershme që keni dhënë?

22 PË. Po, po, sigurisht.

23 PY. A ju kujtohet se keni bërë disa sqarime, disa korrigjime,
24 në këto deklarata gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë?

25 PË. Po, mendoj se po. Nuk jam i sigurt.

1 PY. Deklaratat ju lexuan ju të gjitha dhe iu bë pyetja se në
2 qoftë se në deklaratat ishte pasqyruar dëshmia që kishit dhënë
3 ju më herët dhe a ju kujtohet që i keni thënë personit që ua
4 lexoi këto deklaratat që në disa deklaratat ishte e nevojshme të
5 bëheshin disa sqarime apo ca korrigjime? Ju kujtohet kjo?

6 PË. Nuk më kujtohen hollësitë. Nuk më kujtohet.

7 PY. Pastaj në fund të procesit, domethënë, pasi iu lexua
8 mbrapsht deklaratat, kishim dhe një shënim me sqarimet
9 përkatëse. A ju kujtohet që ky shënim me sqarimet dhe
10 korrigjimet përkatëse iu lexua ju i tëri?

11 PË. Po, më kujtohet që m'u lexua. Më kujtohet.

12 PY. A konfirmoni se ajo çfarë ju lexua juve nga ky shënim a
13 pasqyrojnë plotësisht dhe me saktësi korrigjimet apo sqarimet
14 e bëra prej jush?

15 PË. Po. Çdo gjë ishte e saktë.

16 PY. Duke përfshirë edhe sqarimet e ofruara në atë shënim,
17 deklaratat me shkrim, që unë i përmenda më herët, a pasqyrojnë
18 me saktësi dëshminë tuaj në qoftë se do ju bëheshin të njëjtat
19 pyetje përsëri përpara Trupit Gjykses?

20 PË. Po, po. Çdo gjë është e saktë, me siguri është.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pas
22 përmbushjes së kriterëve të rregullës 154 dhe në pajtim me
23 vendimin F01848, ZPS-ja kërkon pranimin në prova materiale të
24 deklaratave të këtij dëshmitari në anglisht, në shqip dhe në
25 serbisht. Gjithashtu kërkoj që të pranohet në prova Shënim

1 Përgatitor numër 1 datë 13 shtator 2023, me numër identifikimi
2 ERN 115381 deri në 112384.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
4 çaktivizuar].

5 Mirë nuk ka asgjë nga Mbrojtjet për të shtuar.

6 Të gjitha ato komentet që u paraqitën nga 007623 në
7 007630, dokumenti i dytë është U000-0009 deri në 0016 RED2,
8 dokumenti i tretë është 07631-TR-ET Pjesa RED2 dhe gjithashtu
9 edhe shënimi i sqarimeve me numër identifikimi ERN 115381 deri
10 në 115384. Të gjithë pranojnë në provë materiale. Ju lutem
11 znj. Sekretare e seancës, caktojini një numër prove materiale
12 secilit prej këtyre dokumenteve.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, një sqarim
14 të vogël në qoftë se më lejoni. A thatë që për dokumentin
15 007631-TR-ET thatë vetëm Pjesa 1? Në fakt duhet të jetë Pjesa
16 1 dhe Pjesa 6?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pjesa 1 dhe
18 6?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo nga Pjesa 1 deri në Pjesën
20 6, domethënë, të gjitha pjesët nga 1 deri tek 6.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Znj. Sekretare, caktoni numrat e provave materiale për të
23 gjitha këto dokumente.

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
25 dokumenti i parë, nga 007623 deri në 007630 dhe dokumenti në

1 serbisht me numër U002-9743 deri në U002-9746 RED2, do të
2 marri numrin e provës materiale P664.

3 Dokumenti i dytë, me numër identifikimi U000-0009 deri në
4 U000-0016 RED2, së bashku me versionet në shqip dhe në
5 serbisht do të marrë numrin e provës materiale P665.

6 Deklarata e tretë, që është nga Pjesa 1 deri në Pjesën 6
7 me numër identifikimi ERN 007631-TR-ET RED2 për Pjesën 1 do të
8 marrë numrin e provës materiale P661.1, për Pjesën 2 numri i
9 provës materiale është P666.2, për Pjesën 3 numri i provës
10 materiale është 666.3, Pjesën 4 merr numrin e provës materiale
11 666.4, Pjesa 5 me numrin e provës materiale P666.5 dhe 6
12 P666.6.

13 Dhe së fundi, shënimi përgatitor me numrin ERN 115381
14 deri në 115384 do të marrë numrin e provës materiale P667.
15 Faleminderit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, këto u
17 pranuan në prova materiale siç u thanë nga Sekretarja.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, propozoj
19 që të lexoj një përmbledhje të shkurtër të deklaratës së
20 dëshmitarit në bazë të rregullës 154.

21 Në qershor të 1999, dëshmitari jetonte në Rahovec bashkë
22 me shoqen dhe djalin. Shkurtimisht pas tërheqjes së policisë
23 ushtarake serbe, mbërritën ushtarët e UÇK-së në Rahovec. Disa
24 syresh shkuan në banesën e dëshmitarit dhe kërkonin armë.

25 Dëshmitari u keqtrajtua, u kërcënua sepse u pretendua që

1 ai nuk donte të jepte armën. Të nesërmen, në Rahovec,
2 komandanti i Rahovecit, komandanti i UÇK-së mbërriti në
3 familjen e dëshmitarit dhe i kërkoi t'i jepte të gjitha armët
4 dhe çelësat e apartamentit, të banesës pra.

5 Dëshmitari dhe shoqja e tij u urdhëruan të largoheshin
6 brenda 15 minutash nga banesa e tyre dhe ata u larguan dhe
7 shkuan në pjesën serbe të fshatit. Më 18 qershor 1999 ose
8 rreth asaj date, djali i dëshmitarit u rrëmbye nga katër
9 ushtarë të UÇK-së me uniforma të UÇK-së dhe të armatosur në
10 praninë e mamasë së tij. Bashkëshortes së dëshmitarit i thanë
11 që djalin do ta merrnin në stacioni e policisë për një
12 intervistë.

13 Pasi morri informacion në lidhje me rrëmbimin e djalit,
14 dëshmitari shkoi në stacionin e policisë së UÇK-së që ndodhej
15 pranë zjarrfikëses, ndërtesës së zjarrfikëses dhe u kërkoi që
16 të lironin djalin. Edhe dëshmitarin e kyçën në një dhomë
17 përreth një orë dhe më pas e liruan pas ndërhyrjes së KFOR-it.

18 Ismet Tara dhe një anëtar i KFOR-it shkuan më pas tek
19 shtëpia e dëshmitarit dhe e garantuan atë edhe shoqen e tij se
20 djalin do ta lironin të nesërmen në mëngjes. Por kjo nuk
21 ndodhi. Të nesërmen, dëshmitari dhe shoqja e tij takuan sërish
22 Tarën, i cili u tha që unë nuk e di ku mund të jetë djali i
23 dëshmitarit.

24 Djali i dëshmitarit nuk u pa më kurrë.

25 Kjo është përmbledhja e deklaratës apo dëshmisë së këtij

1 dëshmitari. Unë kam disa pyetje sqaruese për këtë dëshmitar.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, unë kam disa pyetje për ju. A jeni gati?

5 PË. Jam.

6 PY. Dëshmitar, në deklaratën që i keni dhënë TFHS-së, Task
7 Forcës Hetimore Speciale - që është Pjesa 4, faqja 26,
8 rreshtat 13, 14 dhe faqja 27, rreshtat 14, 17 dhe faqja 21,
9 rreshtat 23 - ju keni thënë se, në qershor të 1999, pasi
10 zbuluat apo morët vesh rrëmbimin e djalit tuaj, ju shkuat tek
11 ish-ndërtesa e policisë në Rahovec. Po ashtu thatë se në një
12 moment të morën anëtarë të UÇK-së të çuan në drejtim të
13 ndërtesës së zjarrfikëses.

14 Tani unë kam një pyetje. Anëtari i UÇK-së që të çoi në
15 këtë ndërtesën e zjarrfikësve, a të tha ndonjë gjë gjatë kohës
16 që po të çonte në këtë ndërtesë?

17 PË. Gjatë kohës që po më çonte atje, pra, në drejtim të
18 ndërtesës së zjarrfikëses, më pyeti, "Ça ke bërë?". Unë iu
19 përgjigja që "S'kam bërë asgjë. Thjesht erdha te komandanti
20 juaj për një intervistë". Ai ma lëshoi krahun dhe unë nuk hyra
21 në fakt, konkretisht, në ndërtesën e zjarrfikëses.

22 Dhe supozoj që edhe djalin po e mbanin të ndaluar atje.

23 PY. Që ta sqarojmë. Të mori një anëtar i UÇK-së dhe po të
24 çonte në drejtim të ndërtesës së zjarrfikëses, pra, ju thoni
25 që ua afruam tek ndërtesa, por pasi bisedove shkurtimisht me

1 të, ai ta lëshoi krahun dhe ju u kthyet pas. Kështu ndodhi?

2 PË. Po. Pas kësaj bisede, ai thjesht vetë më lëshoi edhe më
3 ktheu pas.

4 PY. Ky anëtar i UÇK-së, a të tha pse po të çonte në ndërtesën
5 e zjarrfikëses?

6 PË. Nuk më tha, nuk më dha arsye pse po ë çonte në ndërtesën
7 e zjarrfikëses.

8 PY. Po ju vetë e dini pse po të çonin në drejtim të asaj
9 ndërtese?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të keni
12 më shumë baza për pyetjet tuaja.

13 Pranohet kundërshtimi i Kehoe.

14 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A mund ta
15 rrisni ju lutem volumin e zërit? Ngriheni pak zërin, ju lutem.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

17 PY. Ju thatë që ju supozoni se tek ndërtesa e zjarrfikëses
18 mund të ishte dhe djali juaj. Ç'ju shtyu të mendonit që edhe
19 djali juaj mund të ishte në atë ndërtesë?

20 PË. Këtë thanë personat. Të gjithë personat që i çonin tek
21 stacioni i policisë më pas i çonin te ndërtesa e zjarrfikëses
22 dhe unë mbështetur në këtë dola në përfundimin që thashë.

23 PY. Ju thatë personat thonin kështu. A mund të na thoni një
24 emër kush ju ka thënë ju që i mbanin personat të ndaluar në
25 ndërtesën e zjarrfikësve?

1 PË. S'mund t'ju them asgjë në lidhje me këtë. Do shpikja
2 pastaj. Nuk mund të them asgjë.

3 PY. A njihni një person me emrin Petko Pelevic? Petko
4 Pelevic.

5 PË. Patjetër që e njoh. Është mbajtur tek ai burgu. E njoh
6 Petko Pelevici mirë. Ka qenë drejtor i një kompanie. E njoh
7 mirë. Atë e shoqëronte një femër nga UÇK-ja.

8 PY. Ju thatë që edhe Petko Pelevici e mbanin atje. Po nga e
9 dini ju që e mbanin në ndërtesën e zjarrfikësve? Nga e keni ju
10 këtë informacion?

11 PË. E kam ditur, por nuk më kujtohet tani. E kam ditur, por
12 nuk më kujtohen hollësitë.

13 PY. Në ndonjë moment me familjarët e Petko Pelevicit kur keni
14 folur për rrëmbimin e tij dhe burgosjen e tij, pra, a mos ka
15 dalë me familjarët e tij ky informacion që ka qenë i burgosur
16 në ndërtesën e zjarrfikësve?

17 PË. Më duket se kam folur me shoqen e tij. Ma merr mendja që
18 kam folur me të.

19 PY. Dhe çfarë ju tha ajo?

20 PË. Më tha se e kishin rrahur atje, e kishte rrahur një grua
21 të cilës ai i kishte dhënë punë në kompaninë e vet, i kishte
22 dhënë një vend pune në kompaninë e vet dhe shoqja pyeste pse e
23 kishte rrahur kjo gruaja kur ai i kishte bërë një nder. Këtë e
24 kam fakt në fakt që ma ka thënë shoqja e tij.

25 PY. Shoqja e Petko Pelevic a ju ka thënë ju se Petko

1 Pelevicin e kanë mbajtur në ndërtesën e zjarrfikëses në

2 Rahovec, pra, a ua ka thënë ajo ju këtë?

3 PË. Po. Ajo ma ka thënë. Ajo. Ai është personi që ma ka
4 thënë.

5 PY. Dëshmitar, në deklaratën që i keni dhënë Task Forcës

6 Hetimore Speciale në Pjesën 1 ju keni thënë diçka në lidhje me

7 ndërtesën e zjarrfikëses. Dëgjoni çfarë keni thënë, faqja 7,

8 rreshtat 15 dhe 16:

9 "Ata më çuan në ndërtesën e zjarrfikëses, supozoj dhe e
10 them me 1000 për qind që ishte një qendër ku mbanin serbët e
11 kidnapuar".

12 Ku e dini ju, Dëshmitar, që në fakt, në ndërtesën e
13 zjarrfikëses ishte si një qendër grumbullimi për serbët e
14 rrëmbyer? Nga e dini ju këtë informacion?

15 PË. E di. E kam, e di e kam fakt. E di që ishte qendër
16 grumbullimi. Pastaj i merrnin personat nga kjo qendër dhe i
17 vrisnin.

18 PY. Po pyetja ime është kjo. Nga e dini ju këtë konkretisht?

19 A ua ka thënë një person? A flisnin personat në Rahovec që ju
20 njihnit? Pra, çfarë mund të na thoni në lidhje me këtë? Nga e
21 dini ju këtë informacion?

22 PË. E kam mësuar prej kësaj gruas që ju thashë.

23 PY. E keni fjalën për shoqen e Petko Pelevicit? Për këtë e
24 keni fjalën?

25 PË. Po.

1 PY. A flitej në fshat mes banorëve serbë të Rahovecit që, në
2 fakt, ndërtesa e zjarrfikëses ishte qendra e grumbullimit për
3 serbët e rrëmbyer, siç e thatë edhe ju?

4 PË. Personat flisnin dhe thonin që tek ky vendi personat i
5 mbanin shumë shkurt dhe pastaj që atje i çonin në një vend
6 tjetër. Por ama, nuk e di se ku.

7 PY. A flitej në fshat që personat që ishin në atë ndërtesë,
8 serbët, pra, që ishin në atë ndërtesë keqtrajtoheshin?

9 PË. Nuk kam dëgjuar asnjë që të thoshte se i keqtrajtonin.
10 Vetëm atë që më tha shoqja e Petkos. Nuk di raste të tjera.

11 PY. E dini çfarë i ndodhi Petko Pelevicit?

12 PË. Vdiq.

13 PËRKTHYESJA: Shënimi i përkthyesit zëri nuk është i qartë
14 dhe nuk arritëm ta merrnim të gjithë fjalinë.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

16 PY. A e dini si vdiq Petko Pelevic?

17 PË. Nga të rrahurat. I kishin thyer krahët, kështu më tha
18 shoqja e tij dhe ishte i mbuluar me gjak. Ma merr mendja se
19 nga e rrahura vdiq.

20 PY. Një pyetje tjetër për shoqen e Petko Pelevicit. Kur ua ka
21 treguar ajo këtë, kur ua ka thënë? Kur ju tregoi për fatin e
22 Petko Pelevicit, faktin që ka qenë i ndaluar në ndërtesën e
23 zjarrfikësve, kur jua ka treguar këtë?

24 PË. Pasi ndodhi ngjarja. Nuk jam i sigurt, por pas ngjarjes.
25 Kur mbaroj e gjithë gjëja. Pra, kur vdiq. Pasi kishte vdekur.

1 PY. Për cilat ngjarje e keni fjalën?

2 PË. Për atë që i ndodhi Petko Pelevicit.

3 PY. Pra, e keni fjalën pas rrëmbimit të Petko Pelevicit? Këtë
4 po thoni?

5 PË. Po.

6 PY. Djali juaj u rrëmbye më 18 qershor të 1999. Sa kohë pas
7 rrëmbimit të djalit tuaj ua tregojë shoqja e Potko Pelevicit
8 historinë, këtë histori?

9 PË. Nuk e di. Nuk më kujtohet.

10 PY. Po s'e di mbase me ditë, disa ditë para apo mbas
11 rrëmbimit të djalit tuaj mbase?

12 PË. Pas. Pas. Ka qenë pas rrëmbimit të djalit tim, prandaj ma
13 tregoi se ndryshe s'do më kishte thënë asgjë.

14 PY. Pra, nuk ju kujtohet sa kohë pas rrëmbimit të djalit tuaj
15 ka ndodhur a ka qenë me ditë, a ka qenë me javë?

16 PË. Jo, nuk më kujtohet. Më besoni që nuk më kujtohet. Nuk më
17 kujtohet se i harroj gjërat tani gjithnjë e më shumë.

18 PY. Pa problem. Ju vetë a keni parë ndonjë serb që ishte i
19 ndaluar në këtë ndërtesën e zjarrfikëses?

20 PË. Jo, asnjë nuk kam parë. Nuk kam parë gjë.

21 PY. A e dini kush ka qenë përgjegjës në atë kohë për
22 ndërtesën e zjarrfikëses?

23 PË. Në daç më besoni në daç jo, i kam ditur dhe emrin dhe
24 mbiemrin. Po tani nuk më kujtohet. E di kush ka qenë drejtori
25 i ndërtesës së zjarrfikëses, po tani nuk më kujtohet.

1 PY. Do jem pak më i qartë se unë vetë nuk isha shumë i qartë
2 dhe ju kërkoj ndjesë për këtë. Pyetja ime lidhet më shumë me
3 faktin që ka qenë një ndërtesë që quhej ndërtesa e
4 zjarrfikëses dhe se flitej në fshat që ka qenë qendër
5 grumbullimi për serbët e rrëmbyer.

6 Unë desha të dija, në atë kohë, a ka pasë ndonjë
7 organizatë apo ndonjë persona që ishte përgjegjës për
8 ndërtesën ku pretendohet se mbaheshin të ndaluar serbët?

9 PË. Nuk e di taman. Ka qenë një grup që ishte përgjegjës.

10 PY. Po çfarë flitej në fshat, nëse vetë nuk e ke parë me sytë
11 e tu, çfarë ke dëgjuar? Kush ishte përgjegjës, cila organizatë
12 ishte përgjegjëse për këtë ndërtesë?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se e
15 keni bërë këtë pyetje dhe keni marrë përgjigjen.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po mendoj se dëshmitari po
17 përpiqet të flasë për një person por mbase nuk është i qartë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë bëj
19 një pyetje dhe më të shkurtër.

20 Z. Kehoe, e kuptoj kundërshtimin tuaj, por do të
21 përpiqemi t'i japim një mundësi tjetër.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, do t'i bëj pyetjet më të thjeshta, më të
24 shkurtra. Ju na thatë se në qershor të 1999 ishte një
25 ndërtesë, ndërtesa e zjarrfikëses dhe flitej në fshat që kjo

1 ndërtesë ishte qendra e grumbullimit për serbët e rrëmbyer, a
2 është kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Kush e kontrollonte këtë qendër grumbullimi për serbët,
5 të serbëve në ndërtesë, pra, cili person dhe cila organizatë
6 në qoftë se ju e dini?

7 PË. S'e kuptova pyetjen tuaj.

8 PY. Do ta bëj përsëri. Na the, na tregove për këtë vendin që
9 ishte vend që grumbulloheshin serbët e rrëmbyer. Cila
10 organizatë ishte përgjegjëse sipas llafeve, fjalëve që të
11 dëgjoni në fshat, kush i mbante serbët atje?

12 PË. Në atë kohë ishin paraushtarakët nga Ministria e
13 Brendshme. Kur fola me komandantin e Rahovecit, Ismet Tarën,
14 ai më tha se paraushtarakët ishin dhe as ai vetë nuk e dinte
15 çfarë bëhej atje. Kishte paraushtarakë, kishte të tjerë.

16 PY. Po ky Ismet Tara i cilës organizatë ishte, kujt i
17 përkiste aso kohe?

18 PË. Është nga Rahoveci. Unë e njoh personalisht. Shkoja
19 shpesh tek restoranti i tij apo te lokali i tij. Haja mëngjes
20 atje te qebaptorja e tij. Ai më ka thënë se ishte komandant i
21 Rahovecit, komandant i UÇK-së për Rahovecin.

22 PY. Flasim pak më shumë për Ismet Tarën. Në deklaratat tuaja
23 të mëhershme - më konkretisht deklarata me numër 007631-TR-ET
24 Pjesa 4, faqja 34 dhe 36 - ju keni thënë se keni biseduar me
25 komandant Ismet Tarën për rastin e djalin tuaj. Dhe unë kam

1 një pyetje për ju.

2 Ju i thatë konkretisht komandant Ismet Tarës se kush
3 besonit ju se ishte përgjegjës, pra, ia thatë emrin e personit
4 që ju besonit që ishte përgjegjës për rrëmbimin e djalit tuaj?
5 I treguat kë mendonit ju se ishte përgjegjës?

6 PË. Më duket se ai vetë ishte përgjegjës. Ai erdhi tek
7 shtëpia ime me një grup me burrash që ishin me uniforma dhe më
8 këshilloi të largohesha nga zona. Më tha mund të vijnë
9 paraushtarakët për 15 minuta. Nuk e di. Mbase kontaktonin me
10 njeri-tjetrin.

11 PY. Dëshmitar, pas rrëmbimit të djalit tuaj, kur u takuat me
12 komandant Ismet Tarën, a i thatë ju atij, pra, a i treguat, a
13 i thatë ju atij lidhur me personin që ju mendonit se ishte
14 përgjegjës për rrëmbimin e djalit tuaj? A i thatë diçka të
15 tillë?

16 PË. Unë s'e pyeta kush ishte përgjegjës. Unë isha në gjendje
17 të atillë aq të keqe sa që as më shkoi nëpër në mend ta bëja
18 një pyetje të tillë. Normalisht duhet ta kisha pyetur atë, se
19 ai ishte personi përgjegjës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuror, e
21 keni kaluar kohën që kishit llogaritur për të bërë pyetjet
22 tuaja.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Dua dhe 10 minuta, në qoftë se
24 është e mundur.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

2 PY. Nuk ju bëra këtë pyetje. Nuk ju pyeta a e pyetët ju z.

3 Tara. Po unë po ju them a i treguat ju atij, pra, ju vetë a i
4 treguat se kush besonit ju se ishte përgjegjës për rrëmbimin e
5 djalit tuaj?

6 PË. I thashë vetëm që më është rrëmbyer djali nga
7 paraushtarakët. Paraushtarakët. Dhe ai më tha "Duhet të
8 largohesh nga banesa", se unë jetoja në pjesën e shqiptarëve
9 dhe më këshilloj të ikja sa më shpejt.

10 PY. Po ju vetë a i propozuat atij, a i dhatë ndonjë emër për
11 ndonjë organizatë që mund të ishte përgjegjëse për rrëmbimin e
12 djalit tuaj?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

15 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I thashë.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

17 PY. Po shoqja juaj a i tha ajo Ismet Tarës kush ishte
18 përgjegjës për rrëmbimin e djalit tuaj? A ia tha diçka të
19 tillë ajo atij.

20 PË. Nuk më kujtohet.

21 PY. Nga deklarata juaj ne e dimë që është shkurtimisht pas
22 rrëmbimit të djalit tuaj, komandant Tara erdhi në banesën tuaj
23 bashkë me një ushtar të KROR-it që quhej Stefan. Ju keni
24 thënë, keni deklaruar se gjatë vizitës komandant Ismet Tara të
25 tha në prani të ushtarit me emër Stefan se e dinte se ku ishte

1 djali juaj, se djalin do t'ua sillnin të nesërmen në mëngjes.

2 Pyetja ime është kjo, a ua sollën djalin të nesërmen?

3 PË. Po, kështu më thanë.

4 PY. Po a e sollën djalin të nesërmen në mëngjes?

5 PË. A mund ta përsërisni pyetjen?

6 PY. A ua sollën djalin të nesërmen siç ju premtoj Ismet Tara?

7 PË. Jo. Pavarësisht se më premtuan, më thanë që do vinin në
8 mëngjes bashkë me djalin tek shtëpia. Nuk ndodhi kjo gjë dhe
9 unë prandaj shkova vetë të hetoja. Po ai ushtari gjerman nuk
10 ishte më në Rahovec. E kishin transferuar në Prizren dhe
11 qëndroi atje. Llafe bosh që do më sillnin djalin që nuk u bënë
12 asnjëherë realitet.

13 PY. A ju dha ndonjë shpjegim Ismet Tara pse nuk ua sollën
14 asnjëherë djalin?

15 PË. Jo. As nuk erdhën fare të më informonin. Është mister. Në
16 vend që të vinin të nesërmen në mëngjes tek shtëpia ime, nuk u
17 dukën më asnjëherë. Stefani, gjermani kishte ikur. Ishte
18 transferuar për në Prizren. Kaq mund t'ju them lidhur me ato
19 që më tha Ismeti. Kaq më tha Ismeti, Stefanin e kanë
20 transferuar.

21 PY. Kam dhe dy pyetje. Në deklaratën që i keni dhënë TFHS-së,
22 Pjesa 4, faqja 36, rreshtat 12 dhe në 13, keni thënë që më
23 vonë u takuat me Ismet Tarën dhe e pyetët për djalin dhe Tara
24 ju tha të largoheshit. Tha "zhduku nga këtu sa më shpejt që të
25 jetë e mundur".

1 Në atë rast kur fole me Ismet Tarën, a ishte Stefani i
2 pranishëm apo ndonjë anëtar tjetër i KFOR-it gjatë asaj
3 bisede?

4 PË. Ja do përpiqem të kujtohem. Ismet Tara ishte vetëm. Jo
5 nuk ishte. Ai ishte vetëm.

6 PY. A e dini ju nëse bëri ndonjë gjë komandanti Ismet Tara
7 për të siguruar lirim të djalit tuaj pasi u transferua
8 Stefani i KFOR-it nga Rahoveci?

9 PË. Ishim bashkë, më premtuan që do ma sillnin djalin.

10 PËRKTHYESJA: Ju lutem dëshmitarit ta përsërisë fjalinë e
11 fundit, fondi i përkthyesit.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 PY. Kjo është tema e fundit që do të diskutoj me ju. Në
14 deklaratën që ke dhënë TFHS-së, Pjesa 4, faqja 33, rreshtat
15 23, 26, thua këtë lidhur me Stefanin, kur të ka pyetur
16 hetuesi.

17 "... më përpara e ke pyetur, e ke kërkuar Stefanin të
18 kontrollojë për Bobanin?"

19 Dhe ai tha:

20 "Po, po të premtoj se do ta bënte po nuk e bëri, nuk mund
21 ta bënte pa UÇK-në, sepse ... ata duhet të bashkëpunonin".

22 Dhe pyetja që kam për ju është, çfarë të bën të mendosh
23 se Stefani i KFOR-it nuk e lironte dot Stefanin pa
24 pjesëmarrjen e UÇK-së?

25 PË. Besoj që Stefani donte të ma sillte djalin, por me gjasa

1 UÇK-ja kishte më ndikim në atë fushë sesa ai. Unë besoj që
2 UÇK-ja ishin përgjegjës. Ata ishin që komandonin edhe pse
3 KFOR-i kishte detyrën për të mbrojtur vendin, por besoj që ai
4 nuk e bënte dot sepse nuk e lanë, nuk e lejuan.
5 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
7 z. Prokuror.

8 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
9 Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
11 vazhdoni.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Më lejoni të them. Në fakt, nuk do
13 t'i bëj pyetje këtij dëshmitari lidhur me dëmin që i është
14 shkaktuar nga humbja e të birit, dua vetëm...

15 E ka takuar e kam diskutuar dhe ai parapëlqen të mos
16 flasë për këtë çështje për arsye të kuptueshme.

17 Ka një diçka tjetër që për të cilën dua ta pyes dhe do ta
18 bëj tani.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
20 vazhdoni.

21 Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

22 Z. LAWS: [Përkthim]

23 PY. Zotëri, ne jemi takuar por po prezantohem dhe një herë.

24 Unë quhem Simon Laws, jam Mbrojtësi i Viktimave në këtë lëndë.

25 Më dëgjoni? Më dëgjoni mirë, z. Dedic?

1 PË. Po ju dëgjoj.

2 PY. Mirëmëngjes. Desha t'ju bëj disa pyetje.

3 PË. Faleminderit shumë.

4 PY. Dua t'ju bëj disa pyetje, nja dy pyetje, në fakt. E dimë
5 që jeni larguar nga Kosova në 1999 dhe dua t'ju pyes nëse jeni
6 kthyer më në Kosovë pas asaj kohe?

7 PË. Jo, nuk jam kthyer më.

8 PY. Mund të na jepni një farë ideje se sa kohë kishin jetuar
9 stërgjyshërit tuaj në Kosovë?

10 PË. Kishim shumë kohë që ishim aty dhe besoj që stërgjyshërit
11 e mi kishin ardhur aty që para 200 vitesh nga Mali i Zi. Por
12 babai im --

13 PËRKTHYESJA: Përkthyesit nuk e dëgjuan përgjigjen.

14 Dëgjuan vetëm një pjesë të përgjigjes se u ndërpre lidhja.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase mund
16 t'ia bëni pyetjen dhe një herë, z. Laws.

17 Z. LAWS: [Përkthim]

18 PY. Për një moment u shkëput lidhja me video, z. Dedic. Ju po
19 na thoshit se stërgjyshërit tuaj kishin mbase 200 vite që
20 jetonin në Kosovë dhe se kishin ardhur nga Mali i Zi. Dhe
21 pastaj nisët të thonit diçka për babain tuaj besoj.

22 Ju kujtohet se çfarë donit të thoshit dhe të na e
23 përsërisni, ju lutem?

24 PË. Më lejoni t'ju them, se pa dyshim që kishim shumë kohë që
25 jetonim aty dhe mua më dukej se kishim qenë gjithmonë aty, por

1 siç më ka treguar babai, origjina jonë ishte nga Mali i Zi.

2 Këtë mund t'ju them lidhur me origjinën tonë.

3 PY. Faleminderit. Këto ishin pyetjet që kisha për ju.

4 Faleminderit.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i japim
7 një pushim të shkurtër dëshmitarit, pastaj mund të filloni t'i
8 bëni pyetjet tuaj.

9 Dëshmitar, do të japim një pushim të shkurtër 15 minuta.
10 Do t'ju shoqërojnë të dilni jashtë nga dhoma.

11 Znj. Sekretare, shoqërojeni dëshmitarin.

12 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
13 këshillohen]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, më
15 dëgjoni? Ju lutem nxirreni dëshmitarin nga dhoma.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
17 Po, do ta bëjmë, i nderuar Gjykatës, menjëherë.

18 [Dëshmitar përfundon dëshminë përmes
19 videolidhjes]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshët të
21 thonit diçka?

22 Atëhere e ndërpresim seancën për 15 minuta.

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të gjitha ekipet e Mbrojtjes kanë
24 marrë nga ZPS-ja një sugjerim, një procedurë të rishikuar për
25 redaktimet. Flas për z. Veseli, ne pajtohemi me propozimin e

1 Prokurorisë, është pak ndryshe nga propozimi juaj por
2 pajtohemi.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ta
4 mbarojmë këtë dëshmitar, mbase do të kemi mundësi që ta
5 diskutojmë këtë çështje.

6 Për 15 minuta bëjmë pushim.

7 --- Pauza fillon në orën 10.08

8 --- Seanca rifillon në orën 10.57

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Para se të
10 fillojmë, shpresojmë që gjithçka është në rregull pas këtij
11 pushimi.

12 Do të vazhdojmë deri në orën 12.30, do të bëjmë pushimin
13 e drekës në 12.30, dhe do të kthehemi këtu në 14.00, dhe deri
14 në 16.00 shpresojmë të vazhdojmë punën dhe të përfundojmë me
15 këtë dëshmitar.

16 Sekretar, mund të sillni dëshmitarin përsëri në dhomë.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [përmes videolidhjes] [Përkthim]
18 Dëshmitari, do të vijë mbas një minute, të nderuar.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

20 [Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se jeni
22 kthyer, Dëshmitar. Ju kërkojmë ndjesë për këtë ndërprerje, por
23 kemi pasur vështirësi teknike.

24 Z. KEHOE: [Mikrofoni çaktivizuar]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk dëgjojmë,

1 dhe pse po flet dëshmitari.

2 Ka përkthim, ndërkohë?

3 DËSHMITARI: [përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju dëgjoj,
4 ju dëgjoj.

5 PËRKTHYESI: Nuk ka mikrofon.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe nuk morëm përkthim për atë që u
7 tha.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Duket sikur ishin ndryshuar
9 kanalet. Prandaj nuk e keni dëgjuar.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Sugjerim i mirë ky.

11 Tani po, dëgjoj. Ju kërkoj ndjesë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, më
14 dëgjon tani?

15 DËSHMITARI: [përmes videolidhjes] [Nuk ka përkthim]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe, që
17 është këtu në sallën e gjyqit ka disa pyetje për ju.

18 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe:

19 Z. KEHOE: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Unë përfaqësoj Presidentin Hashim
21 Thaçi dhe dua t'ju bëj disa pyetje. Nuk do të jenë të shumta.

22 Në qoftë se ju bëj një pyetje dhe nuk e kuptoni, më thoni, dhe
23 do të përpiqem ta riformuloj apo ta bëj më të qartë. Dakord?

24 PË. Po, në rregull. Faleminderit shumë.

25 PY. Dhe një gjë tjetër, ndonjëherë kur pyesim dhe marrim

1 përgjigje, mund të ndodhë që unë të flas përpara se sa ju ta
2 keni përfunduar pyetjen. Dhe për këtë ju kërkoj ndjesë, por ju
3 lutem na njoftoni në qoftë se s'e keni përfunduar përgjigjen,
4 se Trupi Gjykses dëshiron ta dëgjojë të gjithë përgjigjen
5 tuaj. E kuptoni?

6 PË. Po, e kuptoj. Faleminderit.

7 PY. Zotëri, dua që të kthehemi pas në kohë në atë që keni
8 dhënë ju, dëshminë që i keni dhënë ZPS-së dhe Task Forcës
9 Hetimore Speciale që ka të bëjë me betejën e Rahovecit në
10 korrik të 1998. A e mbani mend këtë?

11 PË. Po.

12 PY. Përpara kësaj beteje, autoritetet serbe po shpërndanin
13 armë dhe municion, po u shpërndanin armë dhe municion civilëve
14 si puna juaj, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Kur filloi beteja, ju dhe civilë të tjerë që jetonit në
17 Rahovec kishit armë, pistoleta, municione, kështu ka qenë?

18 PË. Po, po.

19 PY. Dhe nga ju pritej që të bashkëpunonit me ushtrinë dhe
20 policinë për të mbrojtur popullsinë serbe nga ndonjë sulm, apo
21 jo?

22 PË. Po, ashtu është. Kështu na thanë, dhe unë nuk mora një
23 pushkë, por një revolver, në fakt. Dhe kisha dhe leje për
24 këtë.

25 PY. Po, keni marrë dhe municione, kështu?

1 PË. Po, edhe municione morëm.

2 PY. Pra, sulmi ndodhi në 17 korrik të 1998, ndërkohë që ju
3 keni qenë në shtëpi, kështu?

4 PË. Po, isha në shtëpi vetëm, vetëm me gruan. Por, aty afër
5 s'kishte serbë të tjerë.

6 PY. Po gjatë ditës asaj, të atij sulmi -- po e ndryshoj.
7 Sulmi zgjati dy a tre orë, kështu?

8 PË. Po, afërsisht kështu ka qenë.

9 PY. Dhe gjatë ditës, MUP-i, policia, i zbrapsi forcat e UÇK-
10 së me sulm të rëndë, përforcime që erdhën nga Prizreni,
11 kështu?

12 PË. Po, po.

13 PY. Gjatë kësaj kohe, ju nuk vutë re ndonjë rrëmbim të
14 civilëve serbë nga UÇK-ja, apo jo?

15 PË. Jo, nuk kam parë diçka të tillë, po ashtu është.

16 PY. Të kalojmë pak më përpara në kohë, në periudhën e
17 qershorit 1998 [sipas përkthimit]. Pra që nga sulmi i
18 Rahovecit në korrik, deri në qershor të vitit 1999, Rahoveci
19 kontrollohej nga ushtria dhe policia serbe, kështu?

20 PË. Po, nuk kishte ushtri, nga policia serbe.

21 PY. Po, erdhi pastaj, edhe ushtria në Rahovec në korrik?
22 Sepse ju na -- i keni thënë Prokurorisë --

23 PË. Po, atëherë erdhën. Ushtria erdhi nga Prizreni për ta
24 mbrojtur Rahovecin, por nuk ishin të vendosur aty.

25 PY. Do të vijmë tek ushtria, tek -- pas pak. Por ju e dini se

1 gjatë gjithë janarit, shkurtit, marsit, prillit, majit, të
2 1999, policia dhe ushtria serbe po i detyronin shqiptarët e
3 Kosovës të largoheshin prej shtëpive të tyre, kështu ka qenë?
4 PË. Po, pjesërisht është e saktë.
5 PY. Cila pjesë është e saktë?
6 PË. E di pse e them këtë? Unë jetoja në një lagje me
7 shqiptarë, dhe ne shkonim mirë, bashkëpunonim. Përballë ishin
8 shqiptarë, dhe ata thanë që "Duhet të largoheni nga Rahoveci".
9 Pastaj ushtria shkoi përpara autobusit dhe tha që "Mund të
10 ktheheni në shtëpi lirisht". Familja që jetonte pranë meje u
11 kthye në shtëpi. Dhe thanë, u ndien mirë që u kthyen, dhe mua
12 më kishin lënë çelësin e shtëpisë, pra ikën dhe u kthyen
13 brenda një dite.
14 PY. Por ju e dini se anëmbanë Kosovën, ushtria dhe policia
15 ushtarake serbe po i detyronte shqiptarët e Kosovës të
16 largoheshin nga shtëpitë dhe fshatrat e tyre, jo vetëm në
17 Rahovec, por dhe në vende të tjera, ju besoj se e dini këtë?
18 PË. E di -- unë di për Rahovecin, por jo për vendet e tjera.
19 Unë isha pensionist i moshuar dhe nuk më interesonin ato
20 gjëra.
21 PY. Kur flas, po flasim për Rahovecin në periudhën qershor
22 1999, ushtria serbe erdhi në Rahovec dhe i tha popullsisë
23 serbe që policia dhe ushtria do të tërhiqeshin si rrjedhojë e
24 marrëveshjes së Kumanovës, kështu ka qenë?
25 PË. Po, po. Ashtu ishte.

1 PY. Më pas, kur u largua ushtria dhe policia, shumë prej
2 popullsisë civile u largua gjithashtu me ta, kështu?

3 PË. Po, ashtu është, saktë. Gruaja ime nuk donte të largohet
4 edhe unë nuk desha të largohesha. Kështu që qëndruam aty. Por
5 një pjesë e popullsisë u larguan bashkë me ushtrinë.

6 PY. Pra, popullsia u largua sepse -- popullsia serbe, u
7 largua me ushtrinë dhe popullsinë sepse kishin frikë nga
8 hakmarrja e shqiptarëve të Kosovës që do të ktheheshin në
9 Rahovec, apo jo?

10 PË. Po, e saktë. Kjo ishte arsyeja, kështu ka qenë. Dhe ishte
11 normale. Por sipas arsyetimit tim unë s'i kisha bërë njeriu
12 keq, prandaj vendosa të qëndroja në shtëpi dhe qëndrova.

13 PY. E kuptoj, dhe nuk po e diskutoj vendimin tuaj në atë
14 kohë, thjesht po bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me atë që po
15 ndodhte në Rahovec në qershor 1999.

16 Pak kohë pas largimit të ushtrisë, popullsisë, bashkë me
17 popullsinë civile, shqiptarët e Kosovës u kthyen në Rahovec
18 dhe kjo filluan të plaçkisnin shtëpitë e serbëve.

19 PË. Po, u kthyen. Është e saktë kjo që po thoni.

20 PY. Këta ishin njerëzit që ishin të vendosur të hakmerreshin
21 për atë që kishte ndodhur, kështu?

22 PË. Besoj po, kështu ka qenë.

23 PY. Dhe, si pasojë e kësaj, njerëzit, shqiptarët e Kosovës, u
24 kthyen dhe filluan të plaçkisnin shtëpitë e serbëve, apo jo?

25 PË. Unë isha në apartamentin tim. Unë flija, unë fjeta me

1 shqiptarë, dhe në mëngjes kur desha të kthehesha në shtëpinë
2 tonë, ajo vuri re që kishin marrë perdet e shtëpisë sepse
3 gjatë natës kishin hyrë shqiptarë në shtëpinë tonë dhe kishin
4 plaçkitur çka mundeshin, dhe që nga ai moment dhe më tej unë,
5 kur u largova nga shtëpia, ata kishin marrë gjithçka.

6 PY. Do t'i ktheheni dhe kësaj teme. Por gjatë kësaj kohe,
7 kishte paraushtarakë me uniformë jo nga Rahoveci, por që
8 erdhën në Rahovec, ka qenë kështu?

9 PË. Po, ashtu ka qenë.

10 PY. Dhe mendoj se gruaja juaj, Bozana, në fakt, Bozanas,
11 Ismet Tara i tha se kishte shumë banda nga Shqipëria që kishin
12 ardhur, dhe se ai nuk mund t'i dinte të gjitha, apo të merrej
13 me të gjitha?

14 PË. Po. Ashtu më tha, po. Ne e njihnim Ismet Tarën dhe ai ma
15 tha atë me singëritet.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Doja t'i jepja referencën kolegëve
17 të Prokurorisë.

18 Është K020-8261-K020-8267 në faqen 265.

19 PY. Pra, porsa që ushtria dhe policia u larguan dhe
20 shqiptarët e Kosovës u kthyen, dhe këto banda me uniformë,
21 ishte kaos, pështjellim i madh në Rahovec, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Këta personat që kishin ardhur me uniformë --

24 PË. I shikoja, mund t'i, i shikoja nga dritarja.

25 PY. Pra, këto personat që erdhën me uniformë dhe civilë të

1 tjerë -- apo individët që kishin ardhur me uniformë, nuk ishin
2 nga zona e Rahovecit, apo jo? Kishin ardhë nga vende të tjera,
3 kështu?

4 Z. MICHALCZUK: [Nuk ka përkthim]

5 DËSHMITARI: [përmes videolidhjes] [Përkthim] Ata që
6 erdhën hynë në apartamentin tim, ishin nga zona përreth, pranë
7 Rahovecit, por nuk ishin nga Rahoveci.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

9 Z. KEHOE: [Përkthim]

10 PY. Ju kishit dëgjuar se kishte persona, paraushtarakë,
11 individë, banditë që kishin ardhur nga Kaçaniku për të
12 shkaktuar trazira në Rahovec, apo jo?

13 PË. Po, po.

14 PY. Dhe Kaçaniku është një qytet që është afër kufirit me
15 Maqedoninë, është larg nga Rahoveci?

16 PË. Në drejtim të Maqedonisë, po.

17 PY. Pra, këta paraushtarakët, banditët, këta që erdhën nga
18 Kaçaniku, ishin këta që bënë këto gjëra, apo jo?

19 PË. Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E kundërshtoj këtë mënyrë
22 pyetjesh, se pak sekonda përpara --

23 Z. KEHOE: [Nuk ka përkthim]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] -- a tha që i pa nga dritarja,

1 ku ta dinte ai që ishin nga Kaçaniku? Ata po vinin nga
2 drejtime të tjera, çështje që ka të bëjë me themelin e
3 pyetjes.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga e di ai,
5 duhet ta pyesi që ishin për shembull banditë.

6 Z. KEHOE: [Përkthim]

7 PY. Kur po flisnit për banditë, në fakt Ismet Tara kështu i
8 quajti, banditë, apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe nga pyetjet e ngjashme që ju bëri ZPS-ja, ju mësuat
11 dhe nga serbë të tjerë se këta paraushtarakë dhe banditë
12 kishin ardhur nga Kaçaniku, apo jo?

13 PË. Kur e pyeta Ismet Tarën për të, ai tha "Ç'të them unë,
14 nuk është ushtria ime kjo. Ata kanë ardhur nga Kaçaniku". Dhe
15 kështu e mësova se -- nga fjalët që më tha ai. Dhe mbase jo
16 vetëm nga Kaçaniku, por kështu kaq dija unë lidhur me këta
17 njerëz që kishin ardhë nga Kaçaniku.

18 PY. Pra, mund të them se gjatë kësaj periudhe mbizotëronte
19 kaosi në Rahovec, apo jo?

20 PË. Po, sigurisht. Po.

21 PY. Dhe në Kosovë vinin njerëz me uniformë, civilë, dhe e kam
22 fjalën për shqiptarët e Kosovës, që kremtonin atë që ata
23 mendonin që ishte fitore ndaj forcave serbe, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe në fakt janë, ka pasur kremtime gjatë mbrëmjeve në

1 Rahovec si pasojë e --

2 PË. Po, po. Kremtonin, qëllonin me armë për të festuar.

3 PY. Për sa i takon plaçkitjeve, dikush me uniformë erdhi dhe
4 ju mori makinën, dhe ai person mori dhe këpucët tuaja, kështu?

5 PË. Po. Ai erdhi dhe e njihja këtë shqiptarin nga Rahoveci,
6 por kishte veshur uniformë për frikësuar të tjerët. Kishte
7 disa këpucë që s'i pëlqenin, dhe mori të mirat. Kështu ndodhi.

8 PY. Dhe ju i thatë ZPS-së, dhe kjo është në faqen P666, faqja
9 -- pjesa 4, faqja 15, se ai nuk ishte ushtar i rregullt,
10 kështu?

11 PË. Jo, nuk ishte ushtar i rregullt. Kështu mendoj sepse nuk
12 do të ishte i veshur aq keq. Gjithashtu, më kërkoi dhe çelësin
13 e derës së garazhit dhe gruaja më tha, "Hidhja çelësat", sepse
14 po kërcënonte, po nga kërcënonte, "Do të vij lart dhe do t'ju
15 rrah". Kështu që ia hodha çelësat nga dritarja. Ai hapi
16 garazhin, dhe mori makinën time.

17 PY. Sot në mëngjes përmendët Ismet Tarën dhe thatë që erdhi
18 në shtëpinë tuaj, në apartamentin tuaj, dhe ishte i veshur me
19 tesha civile, kështu?

20 PË. Po, ishte i veshur me tesha civile.

21 PY. Dhe ai erdhi me katër ushtarë të tjerë të cilët ishin nga
22 Rahoveci, kështu?

23 PË. Ishin me uniformë. A ishin nga Rahovec apo jo, këtë nuk e
24 di.

25 PY. Por ushtarët që kishin ardhur më parë --

1 PË. Ishin shoqëruesit e tij, por nuk e di nëse ishin nga
2 Rahoveci.

3 PY. Ju e dini -- ju menduat se ishin të asaj zone sepse
4 flisnin serbisht, kështu?

5 PË. Po, po. Flisnin serbisht. Prandaj mendova se ishin të
6 gjithë nga Rahoveci.

7 PY. Ushtarët që kishin ardhur përpara tyre, që nuk i njihnit
8 --- nuk i njihnit ata, kështu?

9 PË. Jo, nuk njihja asnjërin prej tyre. Ata u futën brenda, më
10 rrahën, më morën abazhurin, dhe bënë shumë gjëra. Por unë
11 mbijetova.

12 PY. Por, me sa keni kuptuar atëherë, nuk ishin nga zona e
13 Rahovecit këta ushtarë?

14 PË. Me sa di unë, jo, nuk ishin nga Rahoveci.

15 PY. Kur Ismet Tara dhe këta katër ushtarët erdhën tek ju, ju
16 i thatë ZPS-së me qëllim -- se kishin ardhë me qëllime të
17 mira, kështu i thatë?

18 PË. Po, me qëllime të mira.

19 PY. Dhe ai ishte i shqetësuar që kishin ardhur ata ushtarët
20 në shtëpinë tuaj, ju kishin keqtrajtuar, dhe ai erdhi që të
21 sigurohej që ju dhe gruaja juaj ishit mirë, kështu?

22 PË. Besoj që po. Dhe e falënderoj për këtë, për këtë gjë.

23 PY. Ju e falënderuat për faktin që ai, Ismet Tara, dhe këta
24 ushtarët e tjerë, ju mbrojtën dhe ju shoqëruan...

25 PË. Ai erdhi për të parë se si isha unë.

1 PY. Ai erdhi sepse ishte i merakosur për ty, kështu?

2 PË. Po, besoj që po. Prandaj dhe më tha që "Duhet të
3 largohesh menjëherë këtej", sepse mendonte se mund të vinin të
4 tjerë shpejt.

5 PY. Këta të tjerët që do të vinin shpejt, pas pak, ishin ata
6 banditë, paraushtarakët, dhe ai nuk i kontrollonte dot ata,
7 kështu?

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ky është spekulim, nga e dinte
9 ai këtë gjë?

10 DËSHMITARI: [përmes videolidhjes] [Përkthim] Besoj që po,
11 kështu.

12 Z. KEHOE: [Nuk ka përkthim]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
14 spekuluese, mund të vazhdoni. Bëni një pyetje tjetër.

15 Z. KEHOE: [Përkthim]

16 PY. Ai ju tha se nuk kishte asnjë kontroll ndaj këtyre
17 banditëve, paraushtarakëve, kështu?

18 PË. Po, kështu më tha.

19 PY. Për shkak të shqetësimit, merakut, që kishte ai për ty,
20 Ismet Tara dhe ushtarët e tij ju shoqëruan ty dhe gruan në
21 zonën serbe që të mos u ndodhte gjë, kështu?

22 PË. Po, unë organizova, u organizova me një fqinj shqiptar me
23 makinë i cili na çoi nga apartamenti ynë në pjesën serbe dhe
24 pata mundësi të marr me vete dhe disa gjëra, ca tesha.

25 PY. Juve në këtë zonë serbe ju shoqëroi Ismet Tara, apo jo?

1 PË. Jo, jo. Nuk na shoqëroi ai. Unë i kërkoja një tjetër
2 shqiptari, një komshiu tjetër, nga lagjja që kishte një
3 makinë. Ne patëm mundësi që të merrnim me vete disa gjëra
4 tonat, që na duheshin. Kështu që unë edhe shoqja ime na dërgoi
5 ky person tjetër pra në zonën serbe.

6 PY. Po flasim për provën materiale P0065 në faqen 12. Ju i
7 keni thënë Zyrës së Prokurorisë që:

8 "Ismet Tara tha se ai besonte, besonte tek unë dhe që ne
9 kishim 20 minuta kohë që të bëheshim gati dhe të largoheshim,
10 dhe ai do të na shoqëronte. A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë
11 Prokurorit?

12 PË. Jo, nuk kam thënë këtë gjë. Nuk na ka shoqëruar ai. Unë
13 jam larguar vetë. Megjithatë, ai tha që duhet të largoheni për
14 10, 15 minuta, 15, 20 minuta.

15 PY. Dhe a ju tha ai që do t'ju shoqëronte ai, siç i keni
16 thënë ju Prokurorit?

17 PË. Nuk mendoj se e ka thënë këtë gjë, nuk e mbaj mend ta kem
18 thënë atë gjë as unë.

19 PY. Në rregull, na thoni vetëm çfarë ju kujtohet, dëshmitar.
20 Kaq na duhet, çfarë ju kujtohet.

21 Pra, ju u dërguat në pjesën serbe të Rahovecit atë ditë,
22 kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Ai ju kërkoi që ta bënit këtë gjë sepse ishte i
25 shqetësuar për ju, dhe për të tjerët, kështu?

1 PË. Ai më tha të largohesha, dhe kur po udhëtoja me makinë në
2 pjesën qendrore të Rahovecit, kishte një grup të madh, një
3 grumbull të madh njerëzish. Shqiptarët po gjuanin makinën ku
4 ishim ne. Ata mund ta shihnin që ne ishim serbë, por shoferi
5 nuk ndaloi, kështu që patëm mundësi që të mbërrinim në vendin
6 e destinacionit pa u dëmtuar.

7 PY. Faleminderit, falë Zotit. Domethënë të nesërmen, pas
8 kësaj --

9 PË. Po, saktë.

10 PY. -- meqenëse ra fjala, djali juaj kishte shkuar tek zona
11 serbe në Rahovec disa ditë përpara sesa të shkonit ju, kështu?

12 PË. Po.

13 PY. Kur ju dhe shoqja juaj shkuat tek zona serbe, gruaja dhe
14 djali shkuan për të marrë disa furnizime të nesërmen, ose të
15 pasnesërmen e asaj dite, kështu ka qenë?

16 PË. Po.

17 PY. E di që ju nuk keni qenë i pranishëm aty, por me sa di
18 unë, shoqja ju tregoi se çfarë kishte ndodhur kur u kthyet,
19 kështu ka qenë?

20 PË. Po.

21 PY. Ajo ju tha se kur nuk ndizej makina e djalit tuaj, një
22 prej ushtarëve që ajo e njihte, që ishte Mustafa Mullallia, i
23 kishte thënë asaj që ajo bënte mirë të largohej nga ai vend sa
24 më shpejt të ishte e mundur, a është kështu, dëshmitar?

25 PË. Po. Po, ka qenë ky shqiptari në oborr dhe gruaja ime e ka

1 njohur atë. Ai ishte maskuar, kishte vendosur një kapele në
2 kokë.

3 PY. Po ky individ, Mustafa Mullallia, ishte ushtar i UÇK-së
4 që i kishte thënë shoqes tuaj që bënte mirë që të largohet,
5 apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Ai i tha asaj se duhet të largohet sepse zona ishte plot
8 me këto trupat e tjerë, me këta banditët dhe paramilitarët,
9 kështu?

10 PË. Po, po.

11 PY. Pra, një person të cilin e njihite shoqja juaj, dhe
12 meqenëse ra fjala përpara se të vazhdojmë me pyetjen,
13 bashkëshortja juaj e njihite atë sepse i kishte dhënë mësim në
14 shkollë, kështu ka qenë?

15 PË. Mendoj se po, por nuk jam shumë i sigurt. Shoqja ime
16 njihite më shumë se sa unë. Njihite më shumë veta se sa unë.

17 PY. Mirë, atëherë dikush që ishte pjesë e UÇK-së po përpiquej
18 që të mbronte shoqen tuaj nga këta individët e tjerë që ishin
19 paramilitarë dhe banditë, a është e saktë kjo?

20 PË. Kështu e mendoja unë, këtë mendoj që u përpoqën që të
21 bënëin ata.

22 PY. Ndërkohë që vijuat, një tjetër komshi shqiptar, Naile
23 Raba, i tha shoqes tuaj që "Duhet që të largoheni, dhe thojini
24 djalit që të mos dalë nga shtëpia sepse këta banditë dhe
25 paramilitarët janë rreth e qark", a është e vërtetë kjo?

1 PË. Po, kështu më kanë thënë.

2 PY. Dhe kur shoqja juaj, domethënë këtë informacion jua dha
3 shoqja juaj, pasi u kthyet, a është kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe në atë moment, djali juaj doli nga shtëpia dhe këta
6 banditët e paramilitarët e morën djalin tuaj dhe e futën në
7 një makinë, kështu ka ndodhur?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe shoqja juaj, që jepte mësim në shkollë në Rahovec,
10 ajo nuk e njihte ndonjë nga këta personat, banditë, apo
11 paramilitarë që e kanë marrë djalin tuaj, apo jo?

12 PË. Jo, nuk e njihte.

13 PY. Pas kësaj, ajo u kthye në shtëpi, ju tha çfarë kishte
14 ndodhur, dhe ju shkuat te stacioni i policisë, kështu ka qenë?

15 PË. Shkova te stacioni i policisë, sepse mua më thanë që e
16 kishin dërguar Bobanin në stacionin e policisë, përderisa
17 shoqja ime qëndroi që të fliste me shqiptarët, i kërkova një
18 tjetër shqiptari që të vinte me mua te stacioni i policisë.
19 Askush nuk donte që të më shoqëronte, thjesht nuk guxonin të
20 më shoqëronin. Kështu që unë shkova vetëm dhe aty më mbyllën,
21 atje më pyetën pse ke ardhur, unë i thashë kam ardhur se po
22 kërkohet djalin tim. I thashë që e kanë sjellë këtu djalin tim
23 për një intervistë. Megjithatë, pavarësisht kësaj ata më
24 mbyllën brenda.

25 PY. Ndërkohë që ju pyetën se pse kishe shkuar atje, kishte

1 një grup burrash me uniforma me lara që ishin përpara

2 ndërtesës kështu ka qenë?

3 PË. Po, përpara ndërtesës.

4 PY. Ju nuk i njohët asnjërin prej atyre burrave aty, apo jo?

5 PË. Jo, jo.

6 PY. Rahoveci është një qytezë e vogël, apo jo? Relativisht.

7 PË. E vogël.

8 PY. Ju nuk njohët asnjë nga këta burrat që ishin me uniforma
9 me lara, apo jo?

10 PË. Unë isha i hutuar, nuk është se u përpoqa që të shihja
11 dhe të njihja ndonjërin prej tyre.

12 PY. Në qoftë se do kesh njohur ndonjërin prej tyre, do na
13 thoje sot që ke njohur njërin apo disa prej tyre, por në fakt
14 nuk ke njohur asnjërin, është e vërtetë kjo?

15 PË. Nuk kam njohur asnjërin.

16 PY. Na thatë që u dërguat te ndërtesa, te selia edhe dikush
17 ju dërgoi te zjarrfikësja, dhe pastaj prej aty u kthyet
18 përsëri tek stacioni i policisë, kështu ka ndodhur?

19 PË. Po.

20 PY. Ju asnjëherë nuk u futët brenda te zjarrfikësja, apo jo?

21 PË. Jo, jo, nuk u futa.

22 PY. Nuk është se keni parë ndonjë person që të keqtrajtohej
23 atje, apo jo?

24 PË. Jo, jo, nuk kam parë gjë.

25 PY. Kur të dërguan përsëri te stacioni i policisë, dhe kur

1 keni qenë brenda policisë, oficeri i KFOR-it, Stefan, erdhi
2 ndërkohë që ju ishit aty, kështu ka qenë?
3 PË. Shoqja ime i kërkoi KFOR-it që të ndërhynte sa më shpejt
4 të ishte e mundur. Ajo u tha atyre që unë kisha shkuar te
5 stacioni i policisë dhe nuk po kthehesha. Kështu që ajo shkoi
6 te stacioni i policisë së bashku me patrullën e KFOR-it dhe
7 kërkoi për mua dhe Boban. E dëgjova atë bisedë, ata njerëz po
8 thonin që jo, këta njerëz nuk janë këtu, as Predrag nuk është
9 këtu, as Boban nuk është këtu. Dhe ndërkohë që po i shikoja,
10 unë bërtita dhe thashë që, "Po, jam këtu, unë këtu, unë jam
11 Predrag". Dhe Stefan e njohu, e dalloj zërin tim. Dhe u tha
12 atyre, po ky qenka këtu. Predrag është këtu.

13 Ata më mbajtën mua në një prej dhomave.

14 PY. Shoqja juaj i tha KFOR-it që të ndërhynte dhe KFOR-i në
15 fakt ndërhyri, apo jo?

16 PË. Po, po. Fatmirësisht, e gjithë kjo ndodhi brenda një
17 periudhe të shkurtër. Nuk kishte kaluar shumë kohë sepse po të
18 kisha qëndruar aty nja gjysmë ore tjetër besoj që do të më
19 kishin dërguar diku tjetër. Megjithatë, ai ia arriti që të
20 vinte ndërkohë që unë isha aty, isha i mbyllur, dhe
21 fatmirësisht prandaj jam gjallë dhe sot e kësaj dite.

22 PY. Pra, kemi një situatë në Rahovec ku situata është e
23 trazuar, është kaotike, njerëzit vinin në Rahovec, kishte
24 banditë dhe paramilitarë që ktheheshin në Rahovec, ndërkohë që
25 KFOR-i po mendohej që të siguronte qytetin, kjo ka qenë

1 situata, është e vërtetë kjo?

2 PË. Po përpiqeshin, po përpiqeshin. Por nuk mendoj se ata
3 ishin mjaftueshmërisht të fuqishëm për ta bërë këtë gjë.

4 PY. Por, e gjithë kjo situatë kaotike po ndodhte gjatë kësaj
5 kohe, apo jo? Domethënë, 17, 18, 19 korrik, kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Mendoj se i thatë Prokurorit më herët sot se KFOR-i nuk
8 kishte kompetenca, nuk kishte fuqi që të lironte djalin tuaj,
9 por KFOR-i paska pasur kompetenca për t'ju liruar ju, kështu?

10 PË. Nuk e di, ata nuk e liruan atë.

11 PY. Stefani, shoku jot nga KFOR-i, erdhi te stacioni i
12 policisë, erdhi dhe juve ju liroi nga aty apo jo?

13 PË. Ai erdhi se donte që të më lironte mua, që të më nxirrte
14 mua. Megjithatë nuk ia doli.

15 PY. Po ai ju liroi juve, apo jo, ia doli që t'ju lironte
16 sepse ju në fund u liruat, apo jo?

17 PË. Nga ku?

18 PY. Nga stacioni i policisë.

19 PË. Jo, nuk më liruan se kërkoi ai.

20 PY. Po kur ju liruan?

21 PË. Në qoftë se më lejoni t'jua shpjegoj të gjithë situatën
22 tani.

23 PY. Le të zhvendosim vëmendjen tek prova materiale 666.4,
24 faqja 30, rreshtat 5 deri në 18, kur Stefan erdhi për t'ju
25 gjetur, për t'ju takuar. Dhe do lexoj pjesën, dhe do ju pyes

1 në qoftë se ia keni thënë këtë ZPS-së.

2 "Unë vendosa, vendosa përderisa gjermanët ishin aty, unë
3 e shtyva derën me bërryllin tim dhe i shtyva tre burra, tre
4 metra më andej, në mënyrë të tillë që gjermanët të më shihnin.
5 E bëra shumë ngadalë, sepse ata po mundoheshin që të më
6 shtynin në mënyrë të tillë që të më kyçnin, të më mbyllnin
7 përsëri. Dhe po flisja në Shqipëri [sipas përkthimit], 'Kush e
8 kërkon Pedrag? Pedrag jam unë'".

9 PË. Po, është e saktë.

10 PY. Pashë që kishte persona të KFOR-it aty, dhe pasi bënë një
11 marrëveshje me shefin, me Stefan, unë u lirova. Është e
12 vërtetë kjo, apo jo?

13 PË. Ata po negocionin, po diskutonin, po bisedonin. Dhe pasi
14 u vërtetua që isha unë -- në fillim ata thanë që nuk isha aty,
15 dhe kur unë u shfaqta, tregova fytyrën time, nuk mund ta
16 mohonin faktin që isha aty. Kështu që për nja gjysmë ore
17 negociuan, biseduan dhe thanë që duhet që të takoheshim nja
18 200-300 metra më andej tek stacioni i benzinës. Dhe më pas dy
19 ushtarë të UÇK-së më dërguan atje. Dhe më pas u dërgova në
20 pjesën serbe të qytetit. E gjithë kjo u bë falë Stefan.

21 PY. Kur u dërguat tek pjesa serbe e qytetit, aty u çuat nga
22 disa ushtarë që ju shanin, ju provokonin, dhe ju thanë se
23 çfarë të këqijash, të gjitha gjërat që kishin bërë serbët, apo
24 jo?

25 PË. Po, sigurisht.

1 PY. Ju e kuptuat, apo jo, që këta persona synonin që të
2 hakmerreshin lidhur me atë që ju kishte ndodhur më herët, apo
3 jo?

4 PË. Mendoj se po.

5 PY. Sa i takon hapave, apo masave që ju morët për të gjetur
6 djalin, dhe ju kërkoj -- më vjen keq, ju shpreh ngushëllimet
7 lidhur me çfarë ju ka ndodhur lidhur me djalin. Por, ju besoni
8 që si Stefan dhe Ismet Tara në fakt po mundoheshin që të
9 gjenin se ku ishte djali juaj, dhe të siguroheshin që ta
10 lironin atë, a është e saktë kjo?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe, më pas, kur juve pyetët më vonë Ismet Tara ju tha që
13 djali është dërguar nga paraushtarakët, paramilitarët në një
14 zonë tjetër, kështu ka qenë?

15 PË. Po.

16 PY. Në fakt, ai ju tha ju se këta ishin paramilitarë mbi të
17 cilët ai nuk kishte fare kontroll, a është e vërtetë kjo?

18 PË. Po, kështu më tha.

19 PY. Këta ishin pjesë e paramilitarëve nga Kaçaniku, sipas
20 Ismet Tarës, kështu?

21 PË. Mendoj se ishin nga Kaçaniku, nuk ishin nga Rahoveci.

22 PY. Në fakt, Ismet Tara ju tha që ata ishin nga Kaçaniku, apo
23 jo?

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem, a mund të na jepni
25 referencën për këtë pyetje?

1 Z. KEHOE: [Përkthim] E thashë më përpara. Do ta tërheq
2 pyetjen në fakt sepse e tha këtë gjë më herët.

3 PY. Erdhi një moment kur ju ishit në pjesën serbe të
4 Rahovecit, në gusht 1999, kur dikush qëlloi me armë në zonën
5 serbe, a është e vërtetë kjo?

6 PË. Po, po.

7 PY. Por, ju nuk e patë personin që shtinte me armë në zonë,
8 apo jo?

9 PË. Jo.

10 PY. Dhe, zona juaj, rajoni juaj në atë kohë ishte ngjitur me
11 bazën e KFOR-it, në mos gabohem, apo jo?

12 PË. Po.

13 PY. Të vazhdojmë më tej, kronologjikisht. Erdhi një moment në
14 tetor, kur ju dhe serbët të tjerë vendosët që do të
15 largoheshit nga Kosova. A është e vërtetë kjo?

16 PË. Po.

17 PY. Vendosët që të shkonit në Malin e Zi, kështu i thatë
18 Prokurorit, në mos gabohem?

19 PË. Po, në Mal të Zi.

20 PY. Kur ishit rrugës për në Mal të Zi, ishit në një autobus
21 ku kishte edhe automobile të tjera së bashku me juve, apo jo?

22 PË. Ishin pesë autobusa dhe 23 makina.

23 PY. Nuk e di në qoftë se përfunduat apo ju ndërpreva. Në
24 qoftë se ju ndërpreva, mund të vazhdoni. Nuk jam i sigurt në
25 qoftë se e dhatë përgjigjen e plotë. Megjithatë do të vazhdoj

1 me pyetjen e radhës.

2 Ishte një grup i civilëve shqiptarë të Kosovës që i kanë
3 plaçkitur këto makina apo automjete që voziteshin nga serbët,
4 kështu ka qenë?

5 PË. Po.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lutem më jepni një çast nëse
7 mundem, të nderuar Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka përkthim]
9 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

10 DËSHMITARI: [përmes videolidhjes] [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

13 PY. Dëshmitar, shumë faleminderit për kohën.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
15 z. Kehoe.

16 Znj. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Young?

18 Z. YOUNG: [Përkthim] Jo.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

20 Z. KEHOE: [Përkthim] E kam informuar Gjykatën që
21 parashikoja një kohë më të shkurtër se ç'kisha vlerësuar
22 paraprakisht.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Mund të merrni kohën që nevojitet, z. Baiesu.

25 Z. BAIESU: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

1 Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu:

2 Z. BAIESU: [Nuk ka përkthim]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
4 kemi disa pyetje nga Mbrojtja e një të akuzuari tjetër kësaj
5 radhe.

6 Z. BAIESU: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
7 PY. Mirëmengjes, unë quhen Victor Baiesu, dhe jam
8 përfaqësuesi i Jakup Krasniqit. Do të filloj duke ju bërë disa
9 pyetje që kanë të bëjnë me një dokument konkret. I kërkoj
10 Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin SITF40010159 deri
11 SITF4001064-ET e rishikuar.

12 PY. Dëshmitar, dëshiroj t'ju bëj disa pyetje lidhur me ca
13 informacion që ka dhënë bashkëshortja juaj në qendrën
14 humanitare në Beograd në korrik të 1999. A e dini ju që
15 bashkëshortja juaj e ka dhënë këtë deklaratë apo jo, siç keni
16 dhënë dhe ju deklaratë për organe të tjera më pas?

17 PË. Po, e di këtë gjë.

18 PY. Në 1999 Boban ka qenë 37 vjeç?

19 PË. Nuk e dëgjova mirë.

20 PY. Pyetja ime është kjo, në qoftë se në 1999 djali juaj
21 Boban, ka qenë 37 vjeç apo jo? A ka qenë 37 vjeç djali juaj në
22 atë kohë apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Ai ishte rezervist ushtrie dhe duke qenë i tillë, duke
25 pasur këtë pozicion, kishte armë në shtëpi, apo jo?

1 PË. Po, po, kishte

2 PY. Në deklaratën e saj, bashkëshortja juaj përshkroi sesi më
3 18 qershor 1999 një grup individësh që kishin uniforma të UÇK-
4 së e grabitën, e morën djalin tuaj dhe e dërguan në stacionin
5 e policisë në Rahovec. Bashkëshortja juaj jua ka thënë këto
6 hollësi juve, apo jo?

7 PË. Po.

8 Z. BAIESU: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares të kalojmë
9 te faqja 3 e këtij dokumenti, ju lutem të paraqitet në ekran
10 faqja 3. Deri në fund, ju lutem. Në faqen 4 vazhdon më tej.

11 PY. Dhe thuhet këtu, pyetje: Gruaja juaj tha që pasi e pa që
12 i kishte ndodhur kjo ra në shok dhe u ndie e sëmurë. A ju
13 kujtohet kjo?

14 PË. Po.

15 PY. Pastaj kishte një grup tjetër të të rinjve të cilët
16 gjithashtu ishin veshur me uniforma të UÇK-së dhe që
17 bashkëshortja juaj i njihte që ishin nga Rahoveci. Ata i
18 sollën ujë dhe një karrige bashkëshortes tuaj në mënyrë të
19 tillë që të mblidhte veten. A ta ka thënë kështu bashkëshortja
20 atë çfarë i ka ndodhur?

21 PË. Po.

22 PY. [Folës që flasin njëkohësisht]

23 PË. Kur ata e morën, ajo e njihte atë shqiptarin që ishte si
24 roje, roje në një qilar në një kompani. Ai e njohu, i tha,
25 "Mësuese, mësuese, ulu edhe mblidhe veten".

1 PY. Dhe ata i ofruan bashkëshortes suaj një shishe ujë edhe
2 një karrige për t'u ulur, kështu?

3 PË. Po, po.

4 PY. A do ishte e drejtë të thuhej, Dëshmitar, se gjatë këtij
5 incidenti këta dy grupe individësh janë sjellë në mënyrë të
6 ndryshme përkundrejt bashkëshortes tuaj?

7 PË. Po.

8 Z. BAIESU: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të kalojmë
9 te faqja 5 e këtij dokumenti.

10 PY. Deri në rastin e incidentit me Boban, ju jetonit në një
11 ndërtesë, në një godinë, ku pjesa më e madhe e banorëve ishin
12 shqiptarë, a është e saktë kjo?

13 PË. Po.

14 PY. Në këtë deklaratë bashkëshortja juaj përshekruan një
15 incident ku pesë paramilitarë i shfiguruan fytyrën një gruaje
16 shqiptare 30 vjeçare. A ju kujtohet ky rast?

17 PË. Po. Më kujtohet, po.

18 PY. A ju kujtohet mesatarisht kur ka ndodhur ky incident, në
19 çfarë date ka ndodhur ky incident?

20 PË. Jo, jo. Nuk më kujtohet dot, s'më kujtohet.

21 PY. Incidenti ka ndodhur në verën e 1999, a është e saktë?

22 PË. Po.

23 PY. Gjatë të njëjtit incident, i njëjti grup paramilitarësh
24 serbë vranë edhe një shqiptar, një burrë shqiptar, apo jo?

25 PË. Nuk më kujtohet.

1 PY. A ju kujtohet në qoftë se djali juaj, Boban, gjatë këtij
2 incidenti ofroi ndihmë, solli për ndihmë një oficer të
3 policisë? Po e bëj edhe një herë pyetjen. Gjatë incidentit,
4 djali juaj, Boban, a solli një polic që të ndihmonte, pra ky
5 ishte një polic me të cilin ai shoqërohej?

6 PË. Nuk më kujtohen, nuk e di.

7 PY. Ju dhe shoqja juaj i kërkuat, e pyetët këtë person kush -
8 - i pyetët këta persona kush ishin, dhe ata ishin, thanë që
9 ishin pjesë e ushtrisë së rregullt, ishin si vullnetarë, por
10 më pas ata kishin zgjedhur të plaçkitnin. A ju kujtohet t'ju
11 ketë thënë diçka të tillë ju personalisht dhe bashkëshortes --
12 [Mikrofoni çaktivizuar].

13 PË. Të jem i sigurtë, s'më kujtohet. E kam harruar, s'kam
14 ç'bëj.

15 PY. Faleminderit, dëshmitar.

16 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Pyetje shtesë?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë.

20 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë një
22 pushim tjetër të shkurtër, dhjetë minuta. Dhjetë minuta.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju lutem shoqërojeni
24 dëshmitarin jashtë ambientit ku ndodhet.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes

1 videolidhjes]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

3 --- Pauza fillon në orën 12.02

4 --- Seanca rifillon në orën 12.14.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitari ka
6 nevojë për pushime.

7 Do kthehemi në orën 14.00. Ta konsiderojmë pushim dreke
8 tani, dëshmitari është shumë i lodhur.

9 Ju kërkoj ndjesë që kemi këtë çorganizim sot, por duhet
10 të keni parasysh që dëshmitari nuk e përballon dot. Kthehemi
11 këtu në orën 14.00.

12 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.15

13 --- Seanca rifillon në orën 14.01

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretar i
15 Gjykatës mund të sillni dëshmitarin në ambientin ku ndodhemi.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë përmes
17 videolidhjes]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se u
19 kthyet, Dëshmitar.

20 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]
21 Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A pushove
23 ndopak? A më dëgjoni? A më dëgjoni, Dëshmitar?

24 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po, ju
25 dëgjoj.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A pushove
2 ndopak?

3 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju lutem, të
4 më ulni pak volumin e zërit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më bëhet
6 qejfi që jeni sërish këtu me ne.

7 Kolegu im, Gjykatësi Barthe, ka disa pyetje për ju.

8 Pyetje nga Trupi Gjykses:

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëdita, Dëshmitar.
10 Shpresoj të më ndiqni; më dëgjoni mirë.

11 PË. Ju dëgjoj.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam disa pyetje për ju, por
13 përpara se të filloja më duhet të them që Trupi Gjykses pati
14 vështirësi të kuptonte disa pjesë të deklaratave tuaja, kështu
15 që pyetjet që kam unë janë thjesht për të qartësuar ndonjë
16 diçka që është e paqartë nga dëshmia që keni dhënë ju sot.

17 A e kuptoni këtë Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e parë ka lidhje
20 me seancën përgatitore që keni pasur me ZPS-në para disa
21 javësh. Më konkretisht më 30 shtator 2023, më 13 shtator. Ju
22 kujtohet që keni pasur një takim me Prokurorinë në shtator?

23 Dëshmitar, a ju kujtohet që takuat një Prokuror në
24 shtator, që është këtu? Në shtator të këtij viti?

25 PË. Po, po e kam takuar. Ashtu është.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Prokuroria ka përgatitur një
2 dokument apo një raport pas këtij takimi. Në paragrafin e 14
3 të këtij shënimi apo të këtij raporti, që është edhe prova
4 materiale 667, të pyetën nëse ta tha Stefani, pra, ushtari
5 gjerman i KFOR-it apo Ismet Tara për djalin që "E dimë ku
6 është, mos ki merak. Nesër deri në orën 10:00 do ta sjellim".
7 Ju jeni përgjigjur që këtë e tha z. Tara.

8 PË. Po, kështu.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju thatë po ashtu se t'u dha
10 përshtypja që z. Tara e dinte shumë mirë se ku ishte Bobani
11 kur e tha këtë. Tani pyetja ime është kjo: Pse mendoni ju që e
12 dinte z. Tara ku ishte djali juaj në ato momente?

13 PË. E tha vetë. Nga ta dija unë. Ai e tha, "E dimë ku është,
14 që është më e rëndësishmja. Edhe nesër paradite do vijmë këtu
15 bashkë me djalin dhe me Stefanin". Fjalët e tij ishin këto.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Në intervistën
17 që keni pasur me TFHS-në, Task-Forcën Hetimore Speciale, në
18 dhjetor, në dhjetor të 2013 ju thatë që e keni takuar z. Tara
19 të nesërmen se po kalonte aty me makinën e tij dhe ai ju tha,
20 citoj: "Paramilitarët e morën dhe kjo është e sigurt" dhe po
21 ashtu tha, sipas jush, sipas jush në intervistën tuaj ka
22 thënë: "Ne nuk e dimë ku është". Dhe kjo është e reflektuar në
23 provën materiale P666.4, faqja 12.

24 Pyetja ime për ju Dëshmitar është kjo: A është e vërtetë
25 që z. Tara ju tha ju të nesërmen në mëngjes që djalin tuaj e

1 morën parashtarakët, pra, militarët dhe se ai nuk e dinte ku
2 ishte djali juaj?

3 PË. E takova dhe shkova në drejtim të KFOR-it. Shkova, po
4 shkoja te KFOR-i. Ai më pyete, "Po pse po shkon atje tani?".
5 Dhe unë iu përgjigja: "Po t'i pyes se ti më the se do vije me
6 djalin tim dhe nuk erdhe me djalin". Dhe ai më tha: "Tani nuk
7 e di ku është". Papritmas ai tha "Unë nuk e di ku është". Nuk
8 e di pse e tha diçka të tillë.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe z. Tara ju tha gjatë
10 bisedës që parashtarakët e morët Bobanin, ju kujtohet? Ju tha
11 kështu z. Tara?

12 PË. Nuk jam i sigurt a tha fjalë për fjalë kështu, por ama
13 tha që "Unë nuk e di ku është".

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Pyetja e
15 radhës po ashtu ka lidhje me seancën përgatitore që keni pasur
16 me Prokurorinë më 13 shtator 2023. Në paragrafin 5 të një
17 raporti tjetër përgatitor që mban shënimin përgatitor numër 2,
18 me ERN 115385 deri në 115387 thuhet se shoqja juaj konkretisht
19 i tha z. Tara, në takimin e parë që patët pas rrëmbimit të
20 djalit, shoqja juaj i ka thënë z. Tara që djalin ua kishte
21 rrëmbyer UÇK-ja dhe se ju Dëshmitar po ashtu i keni thënë z.
22 Tara në një takim të mëpasshëm, citoj:

23 "Ata janë njerëzit tuaj...".

24 "Njerëzit tuaj e bënë këtë".

25 Pyetja ime është kjo: A ju kujtohet t'ia keni thënë diçka

1 të tillë Prokurorisë më 13 shtator 2023?

2 PË. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet të kem thënë
3 ekzaktësisht kështu. Ka mundësi që po. Ka kaluar shumë kohë. I
4 kam harruar.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ka problem. Ju kujtohet
6 t'i keni thënë z. Tara në vitin 1999, "Ata janë njerëzit
7 tuaj", njerëzit tuaj e bënë? Ata e rrëmbyen djalin? Ju
8 kujtohet kjo?

9 PË. Po ja kam thënë. Duhet ta dinte besoj. Po ky ishte
10 përfundimi im, këtë i thashë.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ndodhi kjo gjatë bisedës
12 që patët me z. Tara të nesërmen në mëngjes kur e takuat në
13 rrugë, ju kujtohet?

14 PË. Në rrugë ai më tha, "Mos dil, mos shko në asnjë vend se
15 paraushtarakët janë ende këtu afër". Kështu ishte. U takuam
16 rastësisht me njëri-tjetrin.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Po ashtu dua
18 të di Dëshmitar, nëse ju tha ndonjë gjë z. Tara kur ju i thatë
19 që njerëzit e tu e morën djalin, e rrëmbyen djalin, ai reagoi?
20 Ju tha ndonjë gjë?

21 PË. Nuk më kujtohet çfarë tha. Ka të ngjarë të ketë thënë
22 ndonjë gjë, por mua nuk më kujtohet fare. E kam harruar.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dëshmitar, po
24 ashtu në një deklaratë që i keni dhënë TFHS-së, që për
25 procesverbal mban numrin P666.4, 666.4, faqja 37, paragrafi 11

1 deri në 12, ju thatë që nga qershori i '99-s, që nga ajo, që
2 nga qershori i '99-s nuk e keni parë më kurrë z. Tara, kështu
3 është?

4 PË. Jo, jo nuk e kam parë më.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ende kështu është apo e keni
6 takuar dhe e keni parë ndërkohë? Mos e keni parë pas kohës që
7 i keni dhënë intervistën TFHS-së e deri më sot, në këtë
8 periudhë.

9 PË. Nuk më kujtohet ta kem parë dhe më vonë jo. Nuk më
10 kujtohet, nuk më kujtohet.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dëshmitar, nuk
12 e di a e dini ju që z. Tara ka folur për ju, për zhdukjen e
13 djalit tuaj në disa raste dhe për procesverbal bëhet fjalë për
14 dokumentin me numër 0832170-TR-ET e Rishikuar [sipas
15 përkthimit], faqja 18 deri në 23 dhe materiali me numër
16 083217-ET, [sipas përkthimit] faqja 1 deri në 7.

17 Dëshmitar në këtë deklaratë z. Tara flet për zhdukjen e
18 djalit tuaj dhe për ju. Edhe z. Tara pretendon se ai nuk ju ka
19 detyruar të largoheni nga banesa, por që në të vërtetë ju ka
20 ndihmuar, sepse ju ishit në rrezik, duke qenë familja e vetme
21 serbe që jetonit në atë pjesë të Rahovecit në atë kohë dhe ai
22 është krenar që ju ka shpëtuar jetën, sepse mund t'ju kishin
23 ndodhur gjëra të tjera.

24 Pyetja ime është kjo: Si do të komentoni në lidhje me
25 këtë?

1 PË. Ai më këshilloi të largohesha, për këtë arsye. Dhe unë u
2 largova, bëra siç më tha ai.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kujtohet nëse z. Tara ju
4 kërkoi të jepnit armë në atë kohë kur ishit në banesën tuaj?

5 PË. Jo. Jo. Më tha, "Duhet të dorëzosh çdo gjë që ke". Unë e
6 dorëzova në momentin e duhur, kështu që s'kishte nevojë pse të
7 më pyeste më tej.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Tara a ju kërkoi çelësat
9 e banesës?

10 PË. Çelësat, nuk më kujtohet të më ketë kërkuar çelësat, nuk
11 më kujtohet diçka e tillë. Me sa di unë, me sa më kujtohet jo,
12 por nuk jam 100 për qind i sigurt.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ju nuk i dorëzuat
14 çelësat e banesës suaj?

15 PË. Jo.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dëshmitar,
17 çfarë ndodhi më pas me banesën tuaj? U kthyet në të, e shitët?

18 PË. E plaçkitën, e plaçkitën, vodhën çdo gjë. Dhe erdhën dhe
19 më kërkuan t'ua shisja dhe unë ua shita për 8 000 marka.
20 Shqiptarët që erdhën dhe më kërkuan ta shisja më bënë
21 shantazh, më thanë, "Në qoftë se e shet sot ta blejmë për 8
22 000 marka; nesër do ta marrim për 5 000 marka, kështu që unë e
23 shita për 8 000 marka atë ditë. E shita përmes një shqiptari
24 tjetër.

25 Dhe personi që mundësoi shitjen, për personin që mundësoi

1 shitjen i dhashë 100, 500 marka. Besojeni ose jo ia kam ditur
2 dhe emrin dhe mbiemrin, por tani nuk më kujtohen.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mos ka qenë ndonjë zyrtar,
4 nëpunës apo ishte thjesht një civil?

5 PË. Ishte thjesht nga këta personat që mendojnë se mund të
6 fitojnë ndonjë para. Thjesht u prezantua vetë; u prezantua
7 vetë se unë nuk mund ta bëja shitjen drejtpërdrejt. Kështu që
8 u detyrova ta bëja shitjen përmes tij.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Z. Tara
10 pretendon që nuk është e vërtetë se ju dhe shoqja juaj i
11 paskeni thënë atij, pra, z. Tara, se djali juaj Bobani ishte
12 rrëmbyer nga UÇK-ja. Por ju i kishit thënë Bobani ka shkuar në
13 qytet ku me sa duket atje u zhduk.

14 Pyetja ime është kjo: A është e vërtetë t'i keni thënë ju
15 ose shoqja juaj z. Tara se Bobani ka shkuar në qytet dhe është
16 zhdukur?

17 PË. Ai u zhduk në praninë e mamasë së tij.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po përsëris pyetjen. Sipas
19 z. Tara ose ti ose shoqja juaj i keni thënë që djali, Bobani,
20 është rrëmbyer dhe sipas tij ju i keni thënë që Bobani shkoi
21 në qytet dhe nga qyteti u zhduk, u zhduk në qytet.

22 PË. Sikurse ju kam thënë, ai u zhduk në praninë e nënës së
23 tij. Ata u larguan bashkë. Si ka mundësi që e la nënën, mamanë
24 vetëm atje dhe morën vetën djalin?

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Tara pretendon edhe më

1 tej që nuk është e vërtetë që ju jeni mbajtur i ndaluar në
2 stacionin e policisë së z. Tara dhe se jeni liruar vetëm me
3 ndërhyrje të KFOR-it. Dhe unë pyetjen e kam, si në vijim, më
4 dëgjoni me kujdes: A është e vërtetë që ju nuk ju kanë mbajtur
5 në stacionin e policisë kur po kërkonit djalin? Ishit i lirë
6 të iknit nga stacioni i policisë nëse dëshironit?

7 PË. Ajo që është e vërtetë është që unë shkova vetë në
8 stacionin e policisë për t'u interesuar dhe atje më mbyllën.
9 Dhe është e vërtetë që kam qenë në burg, më burgosën atje. Më
10 mbajtën atje. Dera nuk ishte e kyçur, se ishte një zyrë, por u
11 dha urdhër edhe mua më mbajtën të ndaluar atje në stacionin e
12 policisë dhe pas ca kohe më lanë të ikja nga stacioni i
13 policisë dhe më shoqëroi një ushtar i UÇK-së dhe më çuan në
14 drejtim të zjarrfikëses. Kështu ishte.

15 Unë nuk doja as të ulesha. Ishte një stol atje në burg,
16 por unë nuk doja të ulesha.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ashtu, z. Tara pretendoi
18 ose pretendon se ju ka takuar edhe ju edhe shogën tuaj rreth
19 10 a 15 herë pas zhdukjes së djalit tuaj, kryesisht në prani
20 të ndërkombëtarëve dhe nga këto 10 a 15 herë, të paktën 5 ose
21 8 herë jeni takuar në stacionin e policisë.

22 Dhe pyetja ime është kjo:

23 A është e vërtetë? A është e vërtetë që ju dhe shoqja
24 juaj e keni takuar z. Tara 10 a 15 herë pas zhdukjes së djalit
25 ku të paktën 5 a 8 herë jeni takuar në stacionin e policisë në

1 Rahovec?

2 PË. Nuk jemi takuar më shumë se 3 a 4 herë. S'ishte nevoja të
3 takoheshim me të 15 herë. Nuk është e vërtetë.

4 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar. Nuk
5 kam pyetjet të tjera. Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
7 kam edhe unë nja 2 a 3 pyetje për ju. Kur thoni
8 "paraushtarakët", lidhur me zhdukjen e djalit tuaj, ç'do të
9 thotë kjo paraushtarakët, çfarë janë paraushtarakët?

10 PË. S'ishte ushtria tamam-tamam. Ishin thjesht persona që
11 kishin veshur vetë uniforma dhe thonin që jemi ushtri. Për mua
12 nuk kishte rëndësi a ishin ushtria a paramilitarë, por Tara më
13 tha, Tara më tha, këta janë paramilitarët, me këto uniformat.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
15 për paramilitarë serbë apo shqiptarë?

16 PË. Vetëm shqiptarë, vetëm shqiptarë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm këtë
18 pyetje kisha. Faleminderit.

19 Gjykatësi Gaynor? Pyetje shtesë. Në vijim të pyetjeve të
20 Gjykatësve?

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo.

23 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

24 Z. O'REILLY: [Përkthim] Jo.

25 Z. YOUNG: [Përkthim] Jo.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo. [sipas përkthimit]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
3 përfunduat dëshminë për sot.

4 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju
5 faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E vlerësojmë
7 përpjekjen tuaj për të ndarë informacionet që kishit.

8 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju
9 faleminderit edhe ju. Faleminderit që e bëtë sa më shpejt këtë
10 seancë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju urojmë
12 gjithë të mirat. Faleminderit.

13 Sekretari i Gjykatës do ju shoqërojë jashtë dhomës ku
14 ndodheni.

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
16 këshillohen]
17 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes
18 videolidhjes]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me kaq
20 mbyllim dhe videolidhjen. Jemi ende në seancë publike.

21 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kishim
23 planifikuar të flisnim lidhur me temën që parashtroi z.
24 Emmerson, por duke patur parasysh kohën jashtë edhe që disa
25 persona duhet të udhëtojnë nëse ka ende trena do ta mbyllim

1 sot seancën dhe do ta diskutojmë temën që kishte propozuar z.
2 Emmerson ditën e hënë.

3 Ju faleminderit për pjesëmarrjen sot. Faleminderit për
4 efikasitetin tuaj edhe mirëkuptimin, duke marrë parasysh
5 situatën që patëm me dëshmitaren.

6 Shihemi ditën e hënë në orën 09.00.

7 Seanca ndërpritet këtu.

8 --- Seanca mbyllet në orën 14.25

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25